

Në bazë të nenit 164, 165, 166, 170, 171, 172, 176 dhe 178 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.178/21), nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014; 20/2015; 33/2015; 72/2015; 129/2015; 27/2016, 120/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe 111/23), Rregullores për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e personave në të gjitha thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup

A. FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore e **GJERMANISTIKËS**

B. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE

1. Zgjedhje të një personi në thirrje bashkëpunëtor-asistent nga fusha mësimore – shkencore **ELEKTROENERGJETIKË (TJETËR);**
2. Zgjedhje të një personi në thirrje bashkëpunëtor-asistent nga fusha mësimore – shkencore **INXHINERIA E KOMUNIKACIONIT DHE PROJEKTIM**
3. Zgjedhje të një personi në thirrje bashkëpunëtor-asistent nga fusha mësimore – shkencore **PLANIFIKIM**
4. Zgjedhje të një personi në thirrje bashkëpunëtor-asistent nga fusha mësimore – shkencore **AUTOMATIKË**

Kushtet dhe kriteriumet për zgjedhje:

Kandidatët duhet të plotësojnë e kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Ta njohë mirë gjuhën maqedone,
- Të jetë në moshë madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Të mos ketë vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim ndalesë të kryerjes së profesionit veprimit apo detyrës.

Përpos plotësimit të kushteve të përgjithshme të lartëpërmendura, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet dhe kriteriumet të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitje për konkurim,

- Biografi të shkurtë-CV,
- Certifikatën e shtetësisë,
- Vërtetim për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës – Vërtetim mjekësor,
- Vërtetim se nuk ka vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim ndalese të kryerjes së profesionit veprimi apo detyrës.
- Dëshmi për njohje të njëres nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, frënge, gjermane).
- Diplomën dhe certifikatën e notave për të dy, përkatësisht të tre ciklet e përfunduara të studimit (nëse arsimit është kryer jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut të bashkangjitet dëshmia për nostrifikim dhe ekuivalenca e notave),
- listë me punimet shkencore dhe profesionale dhe nga një egzemplar të punimeve shkencore dhe profesionale, edhe ato për pikën A1 më së paku 5 punime shkencore; dhe
- Vendim për përzgjedhje të mëparshme në thirrje mësimoro-shkencore (nëse posedon).

-Dokumentet e lartëcekura të dorëzohen original ose të verifikuara në noter.

Orari i punës do të përcaktohet në përputhje me orarin e orëve mësimore dhe akteve të Universitetit. Shuma e pagës bazë neto për këtë pozicion është në përputhje me aktet e Universitetit, angazhimin mësimor të asistentit në semestrin në të cilin bëhet përzgjedhja, deri në **37.805** denarë për pikët B1,B2, B3 dhe B4, deri në **52.614** denarë për pikën A1.

Konkursi zgjat **tre (3) ditë pune** duke e përfshirë ditën e shpalljes së konkursit, dhe zgjat **deri me datë 26.10.2023**. Fletëparaqitjen me dokumentet kandidatët duhet ti dorëzojnë në hapsirat e kampusit Universitar të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në rr.”Stari vodovod” p.n., me dedikim: Për konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirjet mësimoro –shkencore, ose për thirrje bashkëpunëtor në **Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup**

A. Fakulteti I Shkencave Humane

B. Fakulteti I Shkencave Teknike

Dokumentet jo të kompletuara dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të shqyrtohen.

Kontakt numri: 02/3161-004

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup